

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës	
Komora inxhinjere Republike Kosovo	
Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
Niveli org. Org. Jedinica Org. Unit	OIRK
Nr. i llogaritjes Br. Stranica Nr. Pages	1
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	920/25
Data: Datum:	11.11.25
PRISHTINË / A	
No.1	

**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Nr. 47-BD/2025
Prishtinë: 11.11.2025

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me nr. Fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nën paragrafi 5.13 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.20 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhën E PËRKOshME, i miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8648/24, dhe në mbështetje të nenit 7 të Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional të Inxhinierëve të Licencuar, e miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8655/24, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 11.11.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet organizimi i trajnimit të tretë të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP) për vitin 2025. Tema e trajnimit: Mbrojtja dhe Siguria në Punë në Fushën e Ndërtimit

Trajnimet do të mbahen sipas këtij orari:

Më 15 Nëntor 2025 – në dy termine: 10:00 – 12:00 dhe 14:00 – 16:00

Trajnimet do të zhvillohen në amfiteatrin 408, 411 dhe 415 të Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës. Trajnerë të caktuar: Burim Islami, Miftar Mehanja dhe Ruzhdi Feka.

Më 22 Nëntor 2025 – në dy termine: 10:00 – 12:00 dhe 14:00 – 16:00

Trajnimi do të zhvillohen në amfiteatrin 415 të Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës. Trajnerë të caktuar: Burim Islami dhe Ruzhdi Feka.

2. Miratohet pagesa prej **100 €** për orë për secilin trajner.
Totali i pagesës për tre trajnerët do të jetë **1,200 €** (nga **400 €** për secilin trajner).
3. Miratohet blerja e një baneri me dimensione 2x3 m (sfond i trajnimit) ku do të shënohet titulli i trajnimit.
4. Miratohet angazhimi i 6 studentëve më 15 Nëntor 2025 dhe 3 studentëve më 22 Nëntor 2025 si mbështetës në organizimin e trajnimit si dhe pagesa nga 50 euro për meditje për secilin.
5. Kohëzgjatja e secilit termin është 2 orë, dhe pjesëmarrësit e trajnimit do të përfitojnë dy (3) pikë kredituese, sipas Vendimit Nr. 28-BD/2025 të Bordit Drejtues.
6. Autorizohet Kryetari i OIRK-së dhe administrata për finalizimin e procedurave organizative për realizimin e trajnimit.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit





Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikqyrës.
- Bordit Drejtues të OIRK-së
- Arkivit të OIRK-së.



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Bordit Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**
Kryetar i OIRK-së 
2. **Mimoza Shahini**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së 
3. **Kadri Morina**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 
4. **Afrim Demiri**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 
5. **Nebi Pllana**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 
6. **Bujar Jupaj**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së 
7. **Sami Kolgeci**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 